

Ndikimet nga Përdorimi i Tokës


- Zënie e përkohëshme për kantieret e ndërtimit.
- Shpronësim i tokës vetëm kur është e domosdoshme.
- Kompensim sipas Legjislacionit shqiptar dhe standardeve të BERZH-it.

Statusi i Projektit

Projekti Paraprak: Përfunduar në 2024


Projekt-zbatimi: Filluar në qershor 2025;

Kohëzgjatja e planifikuar: 24 muaj.



Korridori Adriatiko-Jonian në territorin e Shqipërisë

Autostrada Murriqan - Lezhë



Kontakt:

Për informacion, komente apo ankesa, lutemi të kontaktoni:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Email: info@arrsh.gov.al
Website: www.arrsh.gov.al

Funded by
the European Union

Western Balkans
Investment Framework WBIF
BUILDING THE EUROPEAN FUTURE TOGETHER

Global
Gateway

European
Investment Bank | Global

"Korridori Mesdhetar: Seksioni
Murriqan – Lezhë i Autostradës,
Projekti i Zbatimit, Përditësimi i
VNMS-së dhe
Dokumentet e Tenderit"

Fletë-prezantim
për Informacion
Publik

Korniza e Investimeve në balkanin
Perëndimor
Asistenca Teknike për Projektet e Infra-
strukturës 12 (IPF12)
AA-011076-003

Përmbledhje e Projektit

Autostrada Murriqan – Lezhë është segmenti i parë i Korridorit Adriatik-Jonian në Shqipëri, pjesë e Rrjetit Kryesor Mesdhetar TEN-T. Projekti shtrihet në rreth 41 km nga hyrja në pikën doganore të Murriqanit deri në Balldren (Lezhë), duke zëvendësuar kështu rrugën ekzistuese të një standardi të ulët me një autostradë moderne akses të rregulluar. Projekti kalon përgjithësisht në një terren të shtrirë bujqësor, duke përfshirë kalimin e Lumit Buna në një zonë me ndjeshmëri të lartë mjedisore. Rruga është projektuar si autostradë e Kategorisë A, sipas Rregullit Teknik Shqiptar të Projektimit të Rrugëve(2015) dhe standardet TEM (2002).

Komponentët Kryesorë të Projektit

Infrastruktura Rrugore dhe Punimet Civile

- Autostradë me dy korsi me shpejtësi të projektuar 120 km/orë.
- Ngushtim i përkohshëm i korsive pranë pikës kufitare për kalim të kontrolluar.
- Punime dheu, argjinatura, prerje shpatësh dhe stabilizim i terrenit.
- Sistemi i kullimit duke përfshirë kuneta, tombino, kanale dhe basene dekantimi.
- Gardh rrethues përgjatë të gjithë gjatësisë.

Kryqëzimet në disnivel (gjithsej 5)

- IC01 Murriqan
- IC02 Velipojë
- IC03 Vau i Dejës
- IC04 Gjadër
- IC05 Balldren

Strukturat

- Ura mbi lumenj, përrenj dhe kanale (përfshirë lumin Buna).
- Nënkalime për rrugët lokale, këmbësorët dhe bagëtinë

Rrjeti i Rrugëve Lokale

- Integrimi i Planeve Rregulluese lokale (Shkodër, Vau i Dejës, Lezhë).
- Përmirësim i rrugëve lokale dhe lidhje të reja për të ruajtur aksesin e komuniteteve.

Studime Mjedisore dhe Sociale

- Përditësimi i studimeve të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe VNM.
- Studime të një-vjeçare mbi biodiversitetin.
- Modelim i ndikimit të emetimeve të trafikut në ajër.
- Anketë socio-ekonomike me personat e prekur nga projekti për nevojat e Planit të Zhvendosjes

Zbatimi dhe Financimi

Nisma e Projektit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe zbatimi nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH). Financimi pritët nga:

- Qeveria Shqiptare
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) – INF Kryesor
- Bashkimi Evropian / WBIF (ndihmë teknike dhe grante të mundshme)

Përfitimet Kryesore

- Lidhje rajonale e përmirësuar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.
- Kohë e reduktuar e udhëtimit dhe rrjedhë e përmirësuar e trafikut përgjatë korridorit veriperëndimor.
- Iguri rrugore e përmirësuar përmes kryqëzimeve në disnivel dhe standardeve moderne.
- Zhvillimi ekonomik për bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Lezhë.
- Krijimi i vendeve të punës gjatë projektimit dhe ndërtimit.
- Kosto më të ulëta operative të automjeteve dhe efikasitet i përmirësuar i logjistikës.

Angazhimi i Palëve të Interesit

Projekti përfshin angazhim të vazhdueshëm me:

- Palët e prekura nga blerja e tokës (zhvendosja dhe mjetet e jetesës)
 - Autoritetet vendore të Shkodrës, Vaut të Dejës dhe Lezhës
 - Komunitetet e prekura përgjatë shtrirjes
 - Institucionet dhe agjencitë kombëtare përkatëse.
- Aktivitetet e angazhimit do të zhvillohen gjatë gjithë veprimtarive që përfshijnë takime dhe konsultime publike, prezantim të dokumenteve të projektit.

Është ndërtuar një mekanizëm për paraqitjen e komenteve, shqetësimeve dhe ankesave i cili është lehtësisht i përdorshëm.

Ndikimet e Mundshme

Ndikimet Mjedisore dhe Masat

Ndikimet kryesore në **fazën e ndërtimit** përfshijnë emetimet në ajër, gjenerimin e mbeturinave, zhurmën, ngacimin e dherave, humbjen dhe fragmentimin e habitateve, shqetësimin e jetës së egër dhe blerjen e tokës private.

Masat thelbësore: zbatimi i planeve të menaxhimit të ndërtimit, shmangien e habitateve dhe periudhave të ndjeshme, restaurimin e zonave të ndikuara, angazhimin e vazhdueshëm të palëve të interesit, kompensimin e drejtë të tokës dhe rikthimin e kushteve të jetesës aty ku është e nevojshme.

Ndikimet kryesore në **fazën e operimit** përfshijnë zhurmën dhe emetimet e trafikut, rrjedhjet e ujërave të ndotura nga rruga dhe vdekshmërinë e kafshëve të egra.

Key measures: ulja e zhurmës, menaxhimi i duhur i kullimit dhe ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rregullt e rrugëve, masat e sigurisë rrugore, masat për mbrojtjen e kafshëve të egra aty ku është e nevojshme dhe monitorimi mjedisor.